

PAULO COELHO

BRIDA

ROMAN

BOTIMET TOENA

PAULO COELHO

BRIDA

roman

Përktheu
Harris Murana

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Titulli në origjinal: *Brida*

*Ky libër u botua sipas marrëveshjes me
Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona, Spain.
www.santjordi-asociados.com
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.*

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Edona Marku

© e kopertinës: Jim Tierney, në bashkëpunim me HarperCollins,
me bazë në Nju-Jork, SHBA.

ISBN 978-9928-348-75-3

© Paulo Coelho, 1990

<http://paulocoelhoblog.com>

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

O Mari e ngjizur pa mëkat,
lutu për ne që të rikthehemi te Ju.
Amen!

Për N.D.L.-në, që ka realizuar mrekullitë;
për Kristinën, që është njëra prej tyre;
dhe për Bridën.

“O cila grua, nëse ka dhjetë dramme¹ dhe
humb një, nuk ndez kandilin dhe fshin
shtëpinë me shumë kujdes derisa ta rigjejë?
Dhe pasi e ka gjetur, thërret miket dhe
 fqinjët duke thënë: “Gëzoni, sepse rigjeta
dramme-n që kisha humbur”.”

Luka, 15, 8-9

¹Dramme - monedhë e kohës.

Vlerësime për romanin “Brida”

“Coelho është një shkrimtar, i cili shkruan në një gjuhë universale.”

~ **The New York Times**

*“Coelho vazhdon të kombinojë
misticizmin me rrëfimin magjik të shpirtit njerëzor.”*

~ **Booklist**

*“Ka ardhur koha për lexuesit... që të nisen në një udhëtim
drejt zbulimit, që do t'i çojë ata
në veprat e këtij shkrimtari të jashtëzakonshëm.”*

~ **USA Today**

*“Paulo Coelho renditet, së bashku me J. K. Rowling dhe Jonh Grisham,
si një ndër shkrimtarët më të suksesshëm në botë.”*

~ **Reuters** (Angli).

*“Një mjeshtër i rrëfimit, Coelho shkruan kaq bukur dhe realizon
kombinimin e duhur të misticizmit dhe realizmit për ta bërë librin
përmbushës dhe frymëzues. ‘Brida’ është një përrallë e mrekullueshme
që të shijon, e cila po të jesh i hapur ndaj konceptit të spiritualitetit dhe
zbulimit të vetes, do të të ofrojë një lexim ndjellës dhe shpërblyes.”*

~ **The Irish Post** (Irlandë).

Në vëmendje

Në librin “Pelegri i Kompostelës” kam zëvendësuar dy nga praktikat e RAM-it¹ me ushtrime perceptimi që kisha mësuar në kohën kur merresha me teatër. Duke qenë se rezultatet ishin perfektshmërisht të njëjta, kjo më kushtoi një qortim të rreptë nga ana e Mjeshtrit tim.

Më tha: “Nuk ka rëndësi nëse ekzistojnë mënyra më të shpejta apo më të lehta: tradita nuk duhet të cenohet asnjëherë”.

Si rrjedhojë, ritualet e pakta të përshkruara te Brida janë po ato që ndër shekuj ndiqen nga Tradita e Hënës - një Traditë e veçantë, që kërkon dije dhe ekspertizë, si edhe eksperiencë, në praktikimin e saj. Të përdorësh ceremoniale të tilla, pa një udhërrëfyes dhe orientim, është e rrezikshme, e pakëshillueshme dhe e kotë - dhe mund të paragjykojë në mënyrë mjaft serioze Kërkimin Shpirtëror.

¹ RAM - praktikë shpirtërore.

Prolog

I kalonte të gjitha mbrëmjet në një kafene, në Lurdes. Unë, një pelegrin i Udhëtimit të Shenjtë në Romë, që duhej të tërhiqej zvarrë për ditë të tëra, në kërkim të Dhuntisë së tij. Ajo, Brida O'Fern, që kontrollonte një pjesë të këtij udhëtimi.

Një mbrëmje, vendosi ta pyeste nëse kishte provuar ndonjë emocion të fortë, duke parë një lloj manastiri, një etapë të atij shtegu në formë ylli që nismëtarët e kishin kaluar përgjatë Pirenejve.

- Nuk kam qenë kurrë këtu, - u përgjigj ajo.

U habit. Në fund të fundit Brida zotëronte një Dhunti.

- Të gjitha rrugët të çojnë në Romë, - shtoi, duke adoptuar një proverb; donte të thoshte që Dhuntitë mund të ishin zgjuar në ndonjë vend. - Unë e përfundova Udhëtimin Tim nga Roma në Irlandë.

Në takimet tona të mëparshme më tregoi historinë e kërkimeve të saj. Në fund të tregimit, e pyeta nëse do të mundesha të shkruaja një ditë atë çka kisha mësuar.

Në momentin e parë tha dakord. Më pas, çdo herë që takoheshim, më nxirrte nga një pengesë. Më kërkoi të ndryshoja emrat e personave të përfshirë, t'i tregoja llojin e lexuesve që do të kishte libri, dhe se si do të mund reagonin persona të ndryshëm.

- Është një pyetje së cilës nuk mund t'i përgjigjem, - i thashë. - Megjithatë, besoj se nuk është ky motivi që po krijon kaq shumë probleme.

- Ke të drejtë, - tha ajo. - Në të vërtetë, mendoj se është një eksperiencë tepër e veçantë. Nuk e di nëse personat mund të nxjerrin ndonjë përfitim.

Ky është një rrezik me të cilin tashmë do përballemi të dy, Brida.

Një tekst anonim i Traditës pohon se përgjatë gjithë ekzistencës, çdo qenie njerëzore mund të sillet në dy mënyra: të ndërtojë ose të mbjellë. Ndërtuesit mund të zgjasin për vite të tëra detyrat e tyre, por vjen një ditë që ata e përfundojnë veprën e tyre. Në këtë moment ndalojnë, dhe hapësira e tyre rezulton e kufizuar nga muret që kanë ngritur. Kur ndërtesa ka mbaruar, jeta e humb kuptimin.

Pastaj janë edhe ata që mbjellin: shpeshherë vuajnë nga stuhitë dhe stinët, dhe rrallë pushojnë. Por në dallim nga ndërtuesit, kopshti nuk rresht së lulëzuarit. Kështu që kërkon vëmendje të vazhdueshme, por në të njëjtën kohë u lejon kopshtarëve të jetojnë një aventurë të madhe.

Kopshtarët do të dinë gjithmonë të njohin njëri-tjetrin, sepse në historinë e çdo planeti është rritja e gjithë Tokës.

Irlandë
gusht 1983 - mars 1984

Verë dhe vjeshtë

- Dua të mësoj magjinë, - tha vajza.

Magjistari e vëzhgoi: xhinse të zbardhura, një bluzë... dhe ajo pamja sfiduese që personat e ndrojtur e marrin edhe atëherë kur nuk duhet. “Kam dyfishin e moshës tënde”, mendoi. Edhe me gjithë këtë e dinte se ndodhej përballë Gjysmës Tjetër të tij.

- Quhem Brida, - vazhdoi vajza. - Ju kërkoj ndjesë që nuk u prezantova. E kam pritur prej kohësh këtë moment dhe jam më tepër në ankth sesa mund ta mendoni.

- Përse do t’i mësosh sekretet e magjisë, - e pyeti ai.

- Për të gjetur përgjigjet e disa pyetjeve që lidhen me jetën time. Për të njohur fuqitë... E ndoshta për të udhëtuar në të kaluarën dhe në të ardhmen.

Nuk ishte hera e parë që dikush shkonte aty, në pyll, për ta pyetur për të gjitha këto. Një kohë kishte qenë një Mjeshtër i Traditave, i njohur dhe i respektuar. Kishte pritur dishepuj të ndryshëm, duke besuar se bota do të ndryshonte hap pas hapi, do të kishte mundur të ndryshonte ata që e rrethonin. Kishte bërë një gabim, por... jo, Mjeshtërit e Traditave nuk mund të bëjnë gabime.

- Nuk mendon se je pak si tepër e re?

- Jam njëzet vjeçe, - replikoi Brida. - Nëse do doja të mësoja baletin do të isha shumë plakë.

Magjistari i bëri shenjë, derisa ajo filloi ta ndiqte nga pas. Filluan të ecnin nëpër pyll, në heshtje. “Është e lezetshme, - mendoi burri, ndërkohë që hijet e pemëve zhvendoseshin me shpejtësi, sepse dielli pothuajse kishte

arritur horizontin. - Por kam dyfishin e viteve të saj.” Çka nënkuptonte se ndoshta do të kishte vuajtur.

Brida ishte e irrituar për heshtjen e atij që ecte pranë: fraza e fundit e saj nuk kishte merituar asnjë koment nga ana e tij. Terreni i pyllit dukej me lagështirë, i mbuluar me gjethe të thata; edhe ajo i vuri re hijet që ndryshonin, sikurse vuri re edhe që mbrëmja po binte me shpejtësi. Së shpejti, do të bëhej errësirë dhe ata nuk kishin pishtar me vete.

“Duhet të kem besim tek ai, - thoshte me vete duke bërë kurajë. - Nëse jam e bindur se do të më mësojë magjinë, duhet edhe të besoj se di të më udhëheqë nëpër një pyll.”

Vazhduan të ecnin. Burri dukej se ecte pa ndonjë ide të saktë, duke u drejtuar një herë në një anë e një herë në një anë tjetër, ndryshuan drejtim, edhe kur nuk kishte ndonjë pengesë në rrugë. Më shumë se një herë erdhën përqark, duke kaluar tri-katër herë në të njëjtin vend.

“Ndoshta po më vë në provë”, mendoi vajza. Ishte e vendosur t’i shkonte deri në fund asaj eksperience, dhe mendohej të tregonte se gjithçka ç’po ndodhte - edhe vërdallisjet në të njëjtin vend - ishin tepër normale.

Kishte ardhur nga larg dhe e kishte pritur shumë këtë moment. Dublini ndodhej rreth 150 kilometra që prej aty, dhe autobusët që mbërrinin në atë fshat ishin me të vërtetë të parehatshëm dhe kishin orare nisjeje absurde. I ishte dashur të zgjohej shumë herët, të udhëtonte për rreth tri orë, si edhe të pyeste në fshat për të, duke u shpjeguar se çfarë kërkonte nga një njeri kaq i çuditshëm. Në fund, i kishin treguar zonën në pyll, ku Magjistari kalonte ditën - por më parë dikush e kishte paralajmëruar për këtë burrë që një herë kishte tentuar të joshte një vajzë të re nga fshati.

“Është një njeri interesant”, mendoi. Tani terreni ngrihej.

Brida filloi të shpresonte që dielli të qëndronte edhe për pak kohë në qiell: kishte frikë se mos rrëshqiste mbi gjethet e lagura që mbulonin tokën.

- Përse do të mësosh magjinë?

Vajza u gëzua që heshtja ishte thyer. Përsëriti përgjigjen që kishte dhënë pak momente më parë.

Burri nuk u duk aspak i kënaqur.

- Ndoshta do ta njohësh, sepse është misterioze dhe okulte. Sepse jep përgjigje që shumë pak qenie njerëzore arrijnë t'i marrin përgjatë gjithë jetës së tyre. Por mbi të gjitha, sepse kthen një të kaluar romantike.

Brida nuk kundërshtoi. Nuk dinte çfarë të thoshte. Dhe e gjeti veten duke dëshiruar që ai t'i kthehej heshtjes së tij: kishte frikë të jepte një përgjigje të papëlqyeshme.

Në fund, pasi kaluan pyllin, mbërritën në majën e një mali. Atje terreni ishte shkëmbor dhe pa bimë - në fakt ishte më pak i rrëshqitshëm. Brida ndoqi hapat e Magjistarit, pa ndonjë vështirësi.

Ai ul në zonën më të ngritur dhe i kërkoi vajzës të bënte si ai.

- Në të kaluarën, kam qenë këtu me njerëz të tjerë, - tha magjistari. - Kishin ardhur të më kërkonin që t'u mësoja sekretet e Magjisë. Por, tanimë, u kam transmetuar gjithçka kam mundur t'iu mësoja: i kam kthyer njerëzimit atë që më është dhënë. Tani dua veç të jetoj në vetmi, të ngjitem nëpër male, të kujdesem për bimët dhe të komunikoj me Zotin.

- Nuk është e vërtetë, - replikoi vajza.

- Çfarë nuk është e vërtetë? - Burri u çudit.

- Po, ndoshta do të komunikosh me Zotin. Por nuk është e vërtetë se dëshiron të jetosh në vetmi.

Brida u pendua për fjalët që tha. Kishte bërë atë pohim ashtu kot, dhe tani ishte tepër vonë për të rregulluar gabimin. Po, ndoshta ekzistonin njerëz të çilëve u pëlqente të rrinin vetëm. Ndoshta ishin gratë ato që kishin më tepër nevojë, se sa burrat, dhe jo e kundërta.

Megjithatë, kur rifilluan të flisnin, Magjistari nuk dukej i irrituar.

- Do të të bëj një pyetje, - i tha. - Duhet të më përgjigjesh absolutisht sinqerisht. Nëse më thua të vërtetën, do të të mësoj atë që kërkon. Nëse më gënjen, nuk do të mund të kthehesh kurrë këtu mbi këtë mal.

Brida lëshoi një psherëtimë lehtësuese. Bëhej fjalë vetëm për një pyetje. Nuk duhej të gënjente: vetëm kaq. Kishte menduar gjithnjë se për të pranuar një dishepull, Mjeshtrit kërkonin prova më të vështira.

Burri u ul përballë saj. Sytë e tij shkëlqenin.

- E zëmë se unë do të filloj të të mësoj gjithçka di, - tha duke e parë drejt në sy. - E zëmë se do të filloj të të tregoj universet paralele që na rrethojnë, engjëjt, shkencën e natyrës, misteret e Traditës së Diellit dhe të Traditës së Hënës. Dhe një ditë kur do të zbresësh në fshat për të blerë ushqim, do të takosh burrin e jetës tënde.

“Nuk do të di ta njoh”, mendoi ajo. Megjithatë vendosi të heshte, tani pyetja i dukej edhe më e vështirë se sa e kishte imagjinuar.

- Ai individ përjeton të njëjtën ndjesi dhe kërkon të të afrohet. Dashuroheni. Ti vazhdon studimet me mua dhe unë të mësoj dijet e Universit gjatë ditës, ai të tregon doktrinën e Dashurisë gjatë natës. Sigurisht, do të vijë një moment në të cilin këto dy gjëra nuk do munden më të ecin së bashku. Duhet të zgjedhësh.

Magjistari ndaloi për disa momente. Pak përpara sesa të formulonte pyetjen pati frikë nga përgjigjja e vajzës.